



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12 shkronja d) dhe 40.2 shkronja j) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 7 të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal nr.04/L-010, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2019, miratoi,

VENDIM PËR MIRATIMIN E NISMËS PËR THEMELIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËR - KOMUNAL

Neni 1

Miratohet nisma e z.Agim Veliut, Kryetar i Komunës së Podujevës, për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal me Komunat;

- Komuna e Prishtinës
- Komuna e Vushtrisë, dhe
- Komuna e Obiliqit

Neni 2

Qëllimi i themelimit të bashkëpunimit ndër-komunal është për aplikim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL, për financimin e projekteve të përbashkëta ndër-komunale të lansuar përmes thirrjes për aplikim, në fushën e infrastrukturës fizike për ofrimin e shërbimeve për qytetarët, përkatësisht investime në trotuareve, ndriçim publik dhe asfaltim të rrugëve në akset rrugore të fshatrave: Stanovc i Epërm – Breznicë – Kozaricë – Barilevë – Lupç i Poshtëm.

Neni 3

Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.

Neni 4

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës, me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës do të autorizohet për fillimin e konsultimeve me Komunat e cekura dhe përgatitjen e propozim Marrëveshjes për bashkëpunim të ndërsjellë.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr. 01-016/01-0027754/19
Podujevë,
29 mars 2019



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi